



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 03.01.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 21.12.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Lego SHPK" për aktivitetin: "Furnizim me paisje mjekesore për QKMF dhe AMU-ritender-pjesa I" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-8612-111 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Lego SHPK" e datës 31.12.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e veçanta kontraktuale për perfaqesim ligjor për nevojat e Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-9412-221, kundër Njoftimit për Vendimin e AK-se për anulim të kontratës-pjesa e parë të AK -së, të datës 26.12.2019, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Mbetet në fuqi Vendimi për anulim të pjesës së parë publikuar me datë: 26.12.2019;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Lego SHPK" me datë 31.12.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me paisje mjekesore për QKMF dhe AMU-ritender-pjesa I" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-8612-111.

Autoriteti Kontraktues, me datë 03.01.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet janë të pa bazuara pasi që Autoriteti Kontraktues ka analizuar me kujdes tenderin e pretenduesit dhe ka konstatuar se rekomandimet e komisionit të vleresimit janë të bazuara për arsyet në vijim:

-Komisioni me të drejte ka konstatuar se pretenduesi nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për furnizime të ngjajshme në vlerën e kërkuar, pasi që dëshmitë e dorëzuara nga Ministria e Shëndetësisë, Spitali "Aloka" dhe "Vita Hospital" kanë të bëjnë

me furnizime me barera dhe material shpenzues dhe ne asnje rast nuk ka deshmi per furnizim me paisje mjekesore te ngjajshme me paisjet e kerkuara ne tender. Poashtu i njejti ka dorezuar nje reference nga Spitali "Lindja" pa asnje deshmi se cka konkretisht eshte dorezuar ne kete institucion. Vlen te theksojme se te tri referencat kane nje ndryshim vetem ne logo, ndersa permbatja e tekstit eshte e njejte ne te trijat.

Ne baze te sqarimeve paraprake u vendos si ne Dispozitiv te Vendimit.

Zyrtarja e prokurimit qe administron kete lende duhet te publikoj kete Vendim ne E Prokurim.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit